



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 17 Korrik 2023

Nr: 706

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE REGJISTRUAR ME NR. 444 ID DHE 449 ID PËR
SHKELJE ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështjeje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

Data: 17 Korrik 2023

Nr: 706

Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 444 dhe 449 ID.”

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitim të denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 5194 prot., më datën 16.5.2023, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i regjistruar me nr. 444 ID, me lëndë *“Thyerje e heshtjes zgjedhore”*, me objekt denoncimi *“Pasi kanë mbyllur fushatën zgjedhore në Tiranë, Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë kanë bërë një vizitë tek Piramida, që sipas medias do të hapë dyert në fundjavë për të qenë qendra më e madhe digjitale në rajon. Sipas pasqyrimeve të medias, artikullit të publikuar nga Agjencia Telegrafike Shqiptare, ATA me titull “Hapet Piramida e Tiranës, Veliq: Qendra më e madhe digjitale në Ballkan”, aty citohet se Kryebashkiaku Veliq, i rikandiduar nga subjekti zgjedhor “PS”, i cili ka deklaruar se: “Sot ne nuk hapim vetëm një ndërtesë, një stoli, apo një pikë observimi dhe një vend për t’u “instagramuar”, por hapim njëkohësisht dhe qendrën më të madhe dixhitale në Ballkan, për të rinjtë dhe të rejtat e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 5193 prot., më datën 16.5.2023, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i regjistruar me nr. 449 ID, me lëndë, *“Afishim material propagandistik”*, me objekt denoncimi *“Në bashkitë Tiranë, Durrës, Kukës, Lezhë, Pogradec, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Korçë, është vënë re prezenca e materialeve propagandistike.”*

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimeve regjistruar me nr. 444 ID dhe 449 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI